[Printo]

[Google Translate]

LIGJ

PER KRIJIMIN E FONDIT TE VECANTE MONETAR PER

ISH-TE DENUARIT E TE PERNDJEKURIT

POLITIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991

"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit

të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

Neni 1

Të krijohet fondi i veçantë monetar për të ndihmuar ish-të

dënuarit e të përndjekurit politikë në plotësimin e kërkesave të

tyre me karakter urgjent. Ky fond përbëhet nga:

a) shuma që caktohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin e

shtetit.

b) shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të

derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore.

c) vlefta e një pjese të ndihmave humanitare për popullin

shqiptar, që do të përcaktohen për çdo rast nga Këshilli i

Ministrave.

ç) vlefta e ndihmave humanitare që japin institucionet

bamirëse dhe personat fizikë e juridikë, shqiptarë ose të huaj,

të caktuar për isht- të dënuarit e të përndjekurit politikë.

Neni 2

Administrimi dhe drejtimet e përdorimit të këtij fondi do të

bëhen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe

e të Përndjekurve Politikë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë

Tiranë, më 1.9.1992

Nr.i ligjit: 7598

Shpallur me dekretin nr. 290, date 4.9.1992, te Presidentit te Republikes se Shqiperise,Sali Berisha.

Copyright 2013 - www.ligjet.org